



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

*Fuqizohemi së bashku...*

Datë: 10.1.2019

## AMSHC • Ditar Nr. 20

*Tetor / Nëntor / Dhjetor / 2018*

### NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Organizata “New Vision” prezanton përmbledhjen e punës 6-mujore për projektin “Kreativiteti Krijon Ndyshim” .....	faqe 2
“Gruaja Intelktuale Shkodrane (GISH)”: Forume civile mbi mjedisin .....	faqe 3
Takim i Grupit Ndërinstitucional të Punës në funksion të raportimit pranë Bashkimit Evropian .....	faqe 3
Takim pune nga Grupi i Punës me përfaqësues të Institucioneve, në luftën kundër korrupsionit .....	faqe 3
Qendra ALTRI organizon “Ditë e Hapur Anti-Korrupsion” .....	faqe 5
Konferenca “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” .....	faqe 6
Forumi 4 Konsultativ kundër korrupsionit - Konflikti i Interesave .....	faqe 7
Sesion Informimi mbi IPA II Cross-Border Mali i Zi – Shqipëri .....	faqe 7
Trupat Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps) – “Aktivitete për ngritjen e partneritetit” .....	faqe 8
Partnerët Shqipëri zhvilloi ankandin e parë LIVE “Rrathë Dhurues” .....	faqe 10
Takime konsultimi me OShC mbi Programin Anti-Korrupsion të AMShC .....	faqe 11
Prezantohet Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës .....	faqe 15

# Organizata “New Vision” prezanton përmbledhjen e punës 6-mujore për projektin “Kreativiteti Krijon Ndryshim”

Tiranë, 19 tetor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në prezantimin e përmbledhjes së punës 6-mujore të Organizatës “New Vision” lidhur me implementimin e projektit “Kreativiteti Krijon Ndryshim”, aktivitet i cili u mbajt në ambjentet e Qendrës Rinore të Tiranës.



Ky projekt mbështetet financiarisht në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC).



Organizatorët e aktivitetit shprehen krenarinë dhe mirënjohjen kundrejt të gjithë vullnetarëve që i janë përkushtuar krijimeve si dhe falenderime përfaqësuesve të AMShC-së për mbështetjen.



## Takim pune nga Grupi i Punës me përfaqësues të Institucioneve, në luftën kundër korrupsionit

Tiranë, 19 tetor 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në takim të personave përgjegjës të Institucioneve përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale, të organizuar nga Sektori i Monitorimit, Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave pranë Ministrisë së Drejtësisë. Qëllimi i takimit fokusohet në qartësimin e mënyrës së raportimit, inspektimit dhe parashikimit të veprimeve që mund të ndikojnë në përmirësimin e procesit të monitorimit të luftës kundër korrupsionit.

## Takim i Grupit Ndërinstitucional të Punës në funksion të raportimit pranë Bashkimit Evropian

Tiranë, 22 tetor 2018

Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), i nominuar si personi përgjegjës për raportim, mori pjesë në takim të anëtarëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës në funksion të raportimit pranë Bashkimit Evropian. Ky raportim përmban informacione lidhur me Kapitullin 23 me procesin screening të integritetit evropian. Për të mbështetur rëndësinë e këtij procesi, takimi u drejtua nga koordinatorët e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë, të përfaqësuar nga ministrat z. Ditmir Bushati dhe znj. Etilda Gjoni. Në takim u vendos lidhur me përcaktimin e një plani takimesh paraprake në funksion të punës së Grupit dhe më tej u diskutua lidhur me përgjegjësitë që duhet të përvetësojë çdo Institucion i përfshirë në këtë grup pune.

## “Gruaja Intelektuale Shkodrane (GISH)”: Forume civile mbi mjedisin

Shkodër, 25 tetor 2018



Shoqata “Gruaja Intelektuale Shkodrane (GISH)” në zbatim të projektit “Së bashku për mjedisin”, i cili mbështetet në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) vijon me organizimin e forumeve civile në qytetin e Shkodrës.



Pjesëmarrësit u treguan të interesuar për të njohur kompetencat e Bashkisë Shkodër në ofrimin e shërbimeve mjedisore. Gjatë diskutimeve, por edhe në grupet e punës u evidentuan problematikat e ndryshme mjedisore dhe pati edhe shumë sugjerime.

Mbetjet urbane, mungesa e hapësirave publike të gjelbëruara dhe mirëmbajtjes së tyre ishin disa nga shqetësimet e ngritura në këtë takim.





# Takim përmbyllës i projektit “Qytetari Aktive në Qeverisjen e Bashkisë Krujë”

Krujë, 30 tetor 2018



Qendra Instituti i Bashkëpunimit Rajonal për Integrim (IBRI) organizoi takimin përmbyllës të projektit me titull “Qytetari Aktive në Qeverisjen e Bashkisë Krujë”, projekt i cili u mbështet financiarisht në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC). Ky projekt synon fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen e Bashkisë së qytetit të Krujës përmes informimit të tyre lidhur me të drejtat qytetare dhe ligjore.



## Qendra ALTRI organizon “Ditë e Hapur Anti-Korrupsion”

Shkodër, 30 tetor 2018



Qendra ALTRI zhvilloi aktivitetin “Ditë e Hapur Anti-Korrupsion” me studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” - Shkodër, i cili u mbajt pranë ambjenteve të Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës.

Ky aktivitet organizohet si pjesë e projektit “Lufta kundër korrupsionit fillon me studentët e drejtësisë që zgjedhin integritetin”, projekt i cili mbështetet financiarisht në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).



Studentët u njohën me ecurinë e projektit, ndërkohë që pati opinione dhe debate të frytshme prej tyre për mjetet e luftimit të këtij fenomeni. Në fund u themelua dhe Klubi i Integritetit me 26 studentë, që tashmë do veprojnë si një strukturë studentore në luftën kundër korrupsionit.





# Konferenca “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”

Tiranë, 2 nëntor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në Konferencën “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”, e cila u organizua nga IDM Albania në ambjentet e “Hotel Tirana International”, në kuadër të Projektit “Përmirësimi i kapaciteteve në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së ShBA në Tiranë.

Tre vjet pas vlerësimit të parë të fenomenit të Radikalizmit fetar (#religiousradicalism) dhe ekstremizmit të dhunshëm (#violentextremism) në Shqipëri, IDM Albania lançoi studimin më të fundit që

bën një analizë të situatës dhe një vlerësim të gjithanshëm të nxitësve dhe faktorëve të tjerë që çojnë apo mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm në nivel kombëtar.

Qëllimi i konferencës dhe studimit është informimi i vendim-marrësve dhe proceseve politikëbërëse, masave institucionale të aktorëve shtetërorë, si edhe veprimeve të aktorëve jo-shtetërorë (shoqëria civile, komunitetet fetare, media etj.) në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në vend, bazuar në Strategjinë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm.



## Forumi 4 Konsultativ kundër korrupsionit - Konflikti i Interesave

Tiranë, 7 nëntor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në Forumin e 4-rt Konsultativ për tematikën e luftës kundër korrupsionit, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, njëkohësisht Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit të financuar nga BE “Mbështetje për Formulimin, Koordinimin dhe Zbatimin e Politikave Anti-Korrupsion”, i cili u mbajt në ambjentet e

Ministrisë së Drejtësisë. Fokusi kryesor i këtij forumi është tema e Konfliktit të Interesit të zyrtarët e lartë të administratës publike, baza ligjore, mënyrat e trajtimit dhe zgjidhja e tij.

Me prezencën dhe ligjërimin e z. Drago Kos, Kryetar i Grupit të Punës për Mitmarrjen pranë Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), paneli i ftuar, vijoi me diskutimet dhe ofrimin e konsultimeve në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit.

## Sesion Informimi mbi IPA II Cross-Border Mali i Zi – Shqipëri

Podgorica (Mali i Zi), 9 nëntor 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në sesionin informues, i cili u zhvillua në kuadër të “IPA II Cross-Border – Program Bashkëpunimi Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020”.

Gjatë sesionit të parë, pjesëmarrësit u informuan mbi Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020, parimet e partneritetit ndërkufitar dhe përmbajtjen e përgjithshme e paketës së aplikimit; ndërsa gjatë pjesës së dytë, ata morën pjesë në workshop me tematikat:



- *Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut*
- *Promovimi i punësimit, mobilitetit të punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore në të gjithë kufirin*

Ky aktivitet u mundëson të gjithë partnerëve potencialë të projektit që të takohen me njëri-tjetrin, të ndajnë dhe diskutojnë për idetë e tyre të projektit.



# Trupat Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps) – “Aktivitete për ngritjen e partneritetit”

Lubjana (Sllovenia), 2 - 7 dhjetor 2018



Në Lubljanë u zhvillua aktiviteti i parë në nivel evropian, për të mbështetur organizatat në takime dhe rrjetëzime brenda programit të Njësisë Evropiane të Solidaritetit.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) përfaqësohet në këtë aktivitet nga z. Andi Kananaj – Drejtor Ekzekutiv si dhe z. Erion Banushi – Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve.

Aktiviteti i krijoi pjesëmarrësve hapësirë për të njohur punët dhe interesat e njëri – tjetrit, për të eksploruar idetë e mundshme për projekte të përbashkëta dhe për të ngritur partneritete cilësore. Aktiviteti mbledhi së bashku 67 pjesëmarrës nga 19 vende të ndryshme dhe grupe interesi, nga të sapoardhurit në program, tek ata, të cilët tashmë janë aktivë në projektet e mobilitetit, por dëshirojnë të punojnë më shumë në këtë përfshirje.

## Elementët e programit:

- *Prezantimi i Trupave Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps)*
- *Ngritja e kapaciteteve për përfshirjen*
- *Aktivitete për ngritjen e partneritetit*
- *Hapësirë për krijimet e projektit dhe krijimin e drafteve*
- *Hapat e Follow Up (krijimi i një rrjeti të organizatave gjithëpërfshirëse, trajnim për organizatat)*







Organizatrat patën mundësi të formonin grupe të veçanta interesi sipas projekteve për të cilat janë të interesuar - qoftë projekte vullnetare, vende pune dhe trajnime.

Ky event u organizua nga MOVIT, Agjencia Kombëtare e Trupave Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps) dhe Erasmus+ Programi "Youth in action" në bashkëpunim me 15 Agjencia Kombëtare të Programit European Solidarity Corps: Zvicër; Portugali; Kroaci; Belgjikë-Flanders; Belgjikë-Franceze; Gjermani; Lituani; Estoni; Bullgari; Qipro; Danimarkë; Suedi; Poloni; Mbretëri e Bashkuar; Finlandë and Salto South East Europe.



# Partnerët Shqipëri zhvilloi ankandin e parë LIVE “Rrathë Dhurues”

Tiranë, 4 dhjetor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në eventin “Rrathë Dhurues 2018”, i cili u organizua nga “Partnerët Shqipëri” për promovimin e filantropisë dhe në mbështetje të iniciativave të cilat do të transformojnë jetën dhe do të sjellin ndryshime të qëndrueshme sociale për komunitete në nevojë.

Rrathë Dhurues (Giving Circle) është një event që zhvillohet në 16 vende të botës, duke mbledhur së bashku individë të cilët përmes shembullit të tyre personal dhurojnë për kauza sociale duke treguar një ndjenjë të lartë qytetare dhe solidariteti njerëzor.



Rrathë Dhurues 2018 i organizuar për herë të parë në Shqipëri, mbledhi së bashku përfaqësues të lartë të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias, artit etj., të cilët ofruan mbështetje financiare dhe materiale për tre iniciativa:



1. Një kopsht për fëmijët e fshatit Bllaçë – Peshkopi, e ndërmarrë nga Vizion OJF
2. Adopto një terapi – Tiranë, një iniciativë e Fondacionit Down Syndrome Albania
3. Edukimi dhe integrimi i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes sportit – Shkodër, nga Shoqata për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian

Shuma totale e mbledhur prej 1,681,874 Lekë kaloi objektivin e vendosur, duke konfirmuar edhe njëherë ndjeshmërinë qytetare ndaj grupeve në nevojë.







Falë ndjeshmërisë dhe vëmendjes së lartë mediatike që mori event, iniciativat vijnë të sigurojnë mbështetje financiare edhe nga individë që nuk mundën të bëhen pjesë e tij.

Eventi Rrathë Dhurues 2018 u mbështet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri si pjesë e aktiviteteve të projektit “EMBRACE – Modele Sipërmarrjeje që ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese”, Balkan Trust for Democracy – një projekt i German Marshall Fund of the United States, Frederick Mulder Foundation, The Funding Network, Credins Invest, Telekom Albania, dhe Iceberg Communications.



## **TAKIME KONSULTATIVE** **me Organizata të Shoqërisë Civile**

*Prezantim, Informim dhe Konsultim mbi Programin Anti-Korrupsion të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC)*

**Nëntor – Dhjetor 2018**

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) organizoi takime me aktorë të shoqërisë civile për Prezantimin, Informimin dhe Konsultimin mbi Programin Anti-Korrupsion të AMShC-së.

Takimet e informimit dhe konsultimit me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile u organizuan në disa qytete të vendit sipas kalendarit:

**PESHKOPI** – 13 nëntor 2018; **KORÇË** – 16 nëntor 2018; **POGRADEC** – 20 nëntor 2018; **VLORE** – 22 nëntor 2018; **PËRMET** – 27 nëntor 2018; **KUKËS** – 4 dhjetor 2018; **BERAT** – 6 dhjetor 2018 dhe **TIRANË** – 7 dhjetor 2018.



## PESHKOPI

13 nëntor 2018



## KORÇË

16 nëntor 2018



## POGRADEC

20 nëntor 2018







## VLORË

22 nëntor 2018



## PËRMET

27 nëntor 2018



## KUKËS


4 dhjetor 2018





## BERAT

6 dhjetor 2018



## TIRANË

7 dhjetor 2018





## Prezantohet Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Tiranë, 14 dhjetor 2018



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, ku u prezantua Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili është një nga tre strukturat kryesore të cilat do të aplikojnë politikat e reja e shtetërore për Diasporën shqiptare.

Në fjalën e tij përshëndetëse ministri tha se Fondi i Zhvillimit të Diasporës ka garancitë e nevojshme juridike të një institucioni publik jobuxhetor i cili kërkon të hapë një faqe të re marrëdhëniesh me donatorët e interesuar. Gjithashtu ai theksoi se krijimi i këtij fondi shpreh faktin se migracioni shqiptar po del nga faza e stacionit të pas viteve 90-të në Perëndim.

E pranishme në këtë prezantim ishte edhe Ministra e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, znj. Sonila Qato, e cila në fjalën e saj tha se institucioni që ajo drejton është i hapur për bashkëpunimin dhe krijimin e politikave të cilat do të mundësonin një angazhim më të madh të Diasporës shqiptare në vendin tonë.

Drejtoresha Ekzekutive e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për Diasporën, znj. Soana Jaupllari bëri një prezantim të përgjithshëm të misionit të këtij institucioni, duke u ndalur tek projektet konkrete që ky fond do të realizojë për të mbështetur anëtarët e Diasporës për të dhënë kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore e shëndetësore.